

Qasja e Publikut dhe e Mediave në Procedurat Gjyqësore: Mediat Ndërmjet Transparencës dhe Dhënies së Informacionit të Gabuar

Rafet Haxhaj*

Abstrakt

Qasja e publikut dhe e mediave në procedurat gjyqësore paraqet një ndër elementet kryesore të transparencës. Publiku në Kosovë është i etshëm që të dijë se çka punohet nëpër gjykata. Në përgjithësi gjykatat në Kosovë kanë hapësirë të vogël dhe mungesë të sallave të gjykimit. Qasja e publikut në seancat gjyqësore rrit njohuritë e publikut për punën e gjykatave dhe besimin e qytetarëve tek gjykatat. Mediat paraqesin një nga mjetet dhe format më efikase të transparencës. Raportimet, historitë apo pjesët interesante nga proceset gjyqësore ishin, janë dhe mbetën çështje mjaft interesante për publikun. Vrasjet e rënda, një divorc i të ashtuquajturve VIP-a, keqpërdorimi i pozitës zyrtare, çështjet me natyrë korrupsioni të udhëheqësve të lartë qeveritarë, udhëheqësve të ndërmarrjeve të mëdha publike, etj, janë vërtetë interesante dhe tërheqëse për median dhe interesante për t'u përfolur. Vështirësi të dukshme në rastet e publikimit të çështjeve gjyqësore në media paraqet edhe jo profesionalizmi i duhur i gazetarëve dhe njohuritë e tyre të pakëta me ligjet në fuqi dhe procedurat gjyqësore. Jo rrallëherë, duke shfrytëzuar mungesën e zëdhënësve nëpër gjykata, papërvojën e gazetarëve, por edhe neglizhencën e redaktorit të caktuar, avokatët gjatë prononcimit të tyre në media, i kanë servitur publikut versionin e tyre lidhur me rastin dhe këtë ia kanë bërë të besueshme publikut, sado që një gjë e tillë përfaqësuesve ligjorë u është e ndaluar me Kodin e Etikës.

Fjalët kyç: Media; Transparencë; Neglizhencë; Redaktor; Avokat; Kodi i Etikës.

1. Transparenca në Sistemin Gjyqësor të Kosovës

Transparenca në kushtet e shoqërisë bashkëkohore paraqet nocionin i cili më së shpeshti përdoret qoftë për të sqaruar një dukuri, proces apo gjendje, qoftë për t'ua

* Msc. Gjyqtar në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë dhe Ekspert trajnues në Institutin Gjyqësor të Kosovës. Opinione të shprehura në këtë artikull janë vetëm të autorit dhe nuk shprehin qëndrimin e organizatës për të cilën ai punon.

bërë të qartë dhe të njohur publikut të gjerë. Zhvillimi i transparencës nëpër etapa të ndryshme të zhvillimit të shoqërisë ka qenë i lidhur domosdo me nivelin e zhvillimit të demokracisë dhe mbi të gjitha kjo paraqet një vlerë të respektueshme të demokracisë. Me zhvillimet që ndodhin në Kosovë transparenca ka hyrë si nocion në të gjitha programet, projektet dhe në fjalorin e përditshëm, qoftë politik, institucional apo edhe publik. Mirëpo ka një diversitet në të kuptuarit e këtij nocioni se çfarë në të vërtetë paraqet ajo për pjesën që përfaqëson institucionet, çfarë paraqet ajo për pjesën që përfaqëson politikën zyrtare, e çfarë paraqet për pjesën që përfaqëson publikun në tërësi.

Sipas enciklopedive, transparenca e shpjegohet si një fenomen që nënkupton tejdukshmëri, dukje, vizibilitet. Disa fjalorë enciklopedikë, për të ilustruar këtë kuptim, e përdorin gotën ose diçka që është me ndërtim të qelqit-diçka që duket në të gjitha anët kuptim ky i cili është marrë nga shkencat ekzakte, si dukuri e fizikës, përkatësisht formës së trupave.¹ Ndërkaq, në veprimtaritë shoqërore transparenca përdoret si metaforë që nënkupton komunikim të lirë, hapje të plotë, informacione të plota, prani dhe mbikqyrje nga ana e publikut dhe llogaridhënie.² Në disa raste nocioni i transparencës është tejet i thjeshtë për t'u kuptuar, por shumë domethënës 'bërja publike e informatave në mënyrë të plotë, të saktë dhe me kohë'.³

Siç u tha më lartë transparenca është e domosdoshme për të gjitha institucionet andaj, rëndësi të veçantë ka edhe për Sistemin Gjyqësor në Kosovë. Shtrohet pyetja se a është Sistemi Gjyqësor transparent para qytetarëve të Kosovës? Përgjigja menjëhere do të ishte se jo. Kjo për shumë arsye. Sistemi gjyqësor ishte përgjegjësi e rezervuar e UNMIK-ut. Administrimi i tij ishte i ndarë ndërmjet Departamentit të Drejtësisë që ishte në kuadër të Shtyllës së Parë të UNMIK-ut dhe Departamentit të Administratës Gjyqësore që ishte në kompetencë të Ministrisë së Shërbimeve Publike. Në një gjendje të këtillë kur bëhëj fjalë për ndonjë sukses të gjyqësorit ai paraqitej si sukses i ndonjërit nga Departamentet, Shtyllës apo ministrisë; ndërkaq kur bëhëj fjalë për dobësitë këto dy hallka pushtetore atë e drejtonin në Këshillin (e atëhershëm) Gjyqësor dhe Prokurorial, se duhet të bëjë kështu apo ashtu, edhe pse dihet se deri me formimin e Këshillit Gjyqësor, ky i fundit nuk i kishte kompetencat e nevojshme në duart e veta.⁴

Po ashtu gjatë kohës së administrimit ndërkombëtar asnjëherë nuk u mendua për bërjen publike të çështjeve të rëndësishme të cilat u kryen nëpër gjykata. Kjo la

¹ F. Durmishi 'Transparenca dhe rëndësia e saj në shoqëri', 14 Buletini i Shoqatës së Gjykatësve të Kosovës, (2007) 7-8.

² Po aty.

³ Shih *Fjalor i shprehjeve parlamentare dhe ligjore*, (OSBE 2005) 254.

⁴ Me formimin e Këshillit Gjyqësor shumë kompetenca mbarten dhe me këtë edhe Departamenti i Administratës Gjyqësore kalon nën administrimin e këtij këshilli.

mundësinë që organizata të ndryshme që monitoronin Sistemin Gjyqësor në Kosovë dhe të cilat funksiononin vetëm në bazë të projekteve, t'i servirnin publikut kosovar vetëm anët e errëta të punës së gjyqësorit. Dhe pak kush në Kosovë mund të besonte se që të fitohej një projekt (donacion) nga ndonjë Organizatë Joqeveritare e caktuar (OJQ), së pari duhej që të paraqitej (fakte e pa fakte) në një sfond shumë të errët. Në mungesë të fjalës së tij në publik gjyqësori shpesh është hedhur në bankën e zezë për shumë çështje që nuk ishin në kompetencat e tij. Ka ndodhur që në një protestë, faji për vrasjen e një polici i është hedhur tërësisht gjyqësorit kur dihet se gjyqësori ende në duart e tij nuk kishte patur as edhe një të arrestuar të vetëm që të mbajë seancat gjyqësore dhe që të japë verdiktin e tij. Këshilli Gjyqësor së fundmi ka emëruar për herë të parë në vitin 2007 zëdhënësin e tij, por, që puna e tij në informimin e publikut është fare e pakët. Gjithashtu, Këshilli Gjyqësor nuk ka reaguar asnjëherë as edhe kur gjykatat janë fajësuar pa ndonjë arsye, as lidhur me ngjarjet e shkurtit dhe marsit 2008 kur janë uzurpuar gjykatat në Mitrovicë e as në rastet kur janë sulmuar apo edhe kërcënuar gjyqtarët. Nëpër gjykata nuk ka zëdhënës që të informojë në mënyrë profesionale publikun dhe mediat lidhur me çështjet për të cilat publiku ka interes të dijë, dhe në mungesë të një zëdhënësi edhe mediat i kanë servirur publikut zhvillimet nga seancat në të shumtën e rasteve në mënyrë jo profesionale.

Përveç këtyre që u theksuan më lartë, transparenca në punën e gjykatave në Kosovë do të shpjegohej me atë se cila është qasja e publikut dhe e mediave në procedurë, a bëhet publikimi i vendimeve gjyqësore si dhe a është bërë ndonjëherë në mënyrë të duhur njohja e publikut me punën e gjykatave.

2. Qasja e Publikut në Procedurat Gjyqësore

Qasja e publikut në procedurën gjyqësore paraqet një ndër elementet kryesore të transparencës. Publiku në Kosovë sikur është i etshëm që të dijë se çka punohet nëpër gjykata. Në pikpamje formale vetë parimi i publicitetit mundësonte në mënyrë mjaft të mirë pjesëmarrjen e publikut nëpër gjykata dhe njohjen e tij me punët e gjykatës. Kushtetuta e Republikës së Kosovës përcakton se:

Gjykimi është publik, me përjashtim të rasteve kur gjykata, në rrethana të veçanta, konsideron se në të mirë të drejtësisë është i domosdoshëm përjashtimi i publikut, ose i përfaqësuesve të medieve, sepse prania e tyre do të përbëntë rrezik për rendin publik ose sigurinë kombëtare, intersat e të miturve, ose për mbrojtjen e jetës private të palëve në proces, në mënyrën e përcaktuar me ligj.⁵

⁵ Kushtetuta e Republikës së Kosovës (neni 31 para. 3).

Ligji mbi Gjykatat ka paraparë se: ‘puna e gjykatës është publike’. Sipas këtij ligji karakteri publik i punës së gjykatës sigurohet me shqyrtimin publik në seancë para gjykatës dhe me shpalljen e përbërjes së kolegjeve gjyqësore, me dhënien e informatave mbi ecurinë e procedurës gjyqësore personave të interesuar në kushtet e parashikuara me ligj.

Kodi i Procedurës Penale i Kosovës (KPPK) përmban dispozita lidhur me publicitetin e shqyrtimit gjyqësor dhe mundësitë dhe mënyrat e pjesëmarrjes së publikut në këto shqyrtime. Neni 328 i këtij kodi përcakton se ‘Shqyrtimi gjyqësor është i hapur, se në të mund të marrin pjesë vetëm personat madhorë dhe se personat e pranishëm (përveç rojeve të të akuzuarit) nuk mund të mbajnë armë ose mjete të rrezikshme’. Po ashtu edhe Ligji mbi Procedurën Kontestimore përmban dispozita mbi publicitetin e seancës kryesore dhe për përjashtimin e publikut nga seanca.⁶ Kodi i Procedurës Penale ka paraparë edhe kufizimet kur mund të përjashtohet publiku dhe këtë trupi gjykues nga fillimi deri në përfundim të shqyrtimit gjyqësor me propozimin e palëve apo sipas detyrës zyrtare, por gjithnjë pas dëgjimit të tyre (palëve) lidhur me këtë çështje mund të marrë vendim, për përjashtimin e publikut gjatë gjithë shqyrtimit apo vetëm nga një pjesë e tij. Këtë trupi gjykues mund ta bëjë kur kjo është e nevojshme për: ruajtjen e fshehtësisë zyrtare, ruajtjen e informacionit të fshehtë, i cili do të rrezikohej nga shqyrtimi i hapur, ruajtjen e rendit dhe respektimin e ligjit, mbrojtjen e jetës personale ose familjare të të akuzuarit të dëmtuarit ose të pjesëmarrësve të tjerë në procedurë, mbrojtjen e interesave të fëmijëve ose mbrojtjen e të dëmtuarëve ose të dëshmitarëve siç parashihet në Kapitullin XXI të këtij Kodi.⁷

Ky Kod ka rregulluar edhe çështjen se përjashtimi i publikut nuk zbatohet për palët, të dëmtuarit, përfaqësuesit e tyre dhe mbrojtësit përveç nën kushtet e përcaktuara me ligj sipas dispozitave për mbrojtjen e të dëmtuarëve ose të dëshmitarëve siç parashihen në kapitullin XXI.⁸ Për më tepër, trupi gjykues mund të lejojë që në seancën në të cilën është përjashtuar publiku të marrin pjesë edhe zyrtarë të caktuar, punëtor shkencor dhe publik dhe me kërkesën e të akuzuarit mund të lejojë pjesëmarrjen e bashkëshortit ose bashkëshortët jashtëmartesor si dhe të afërmit e tij. Është rregull se kryetari i trupit gjykues paralajmëron personat të cilët marrin pjesë në shqyrtimin gjyqësor të mbyllur se detyrohen që të ruajnë

⁶ Shih, Ligji për Procedurën Kontestimore (nenet 444 – 448).

⁷ Shih, Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, neni 329.

⁸ Kapitulli XXI i Kodit të Procedurës Penale në nenet 168-174 ka paraparë kushtet nën të cilat mund të bëhet mbrojtja e të dëmtuarve dhe dëshmitarëve në procedurën penale. Në mungesë të krijimit të infrastrukturës përcjellëse këto dispozita në kushtet e Kosovës ende mbeten larg zbatimit të tyre. Për më tepër shih edhe OSCE-misioni në Kosovë, *Siguria dhe Mbrojtja e dëshmitarëve në Kosovë: Vlerësim dhe rekomandime* (2007).

fshehtësinë e informatave të cilat i kanë mësuar në shqyrtimin gjyqësor dhe se zbulimi i fshehtësisë përbën vepër penale.⁹

Përfundimisht e publikut nga seancat e ka paraparë edhe Ligji për Familjen i Kosovës, i cili përcakton se publiku përjashtohet nga procedurat që kanë të bëjnë me kontestet martesore.¹⁰ Sipas këtij ligji, publiku është i përjashtuar edhe në kontestet për vërtetim apo kundërshtim të atësisë dhe kontestet për kujdestari të personit të mitur dhe kjo bëhet me qëllim të sigurimit të mbrojtjes për fëmijën.¹¹

Se sa është e mundshme që publiku të marrë pjesë në seancat gjyqësore kjo më së miri, mund të matet me hapësirën e gjykatave në të cilat zhvillohen proceset gjyqësore. Në përgjithësi, gjykatat në Kosovë kanë hapësirë të pakët dhe mungesë të sallave të gjykimit. Gjyqtarët janë të detyruar që në shumë raste seancat gjyqësore t'i mbajnë nëpër zyret e tyre të punës dhe kjo gjithsesi në shumë raste nuk ka ofruar edhe pjesmarrje të të gjithë të interesuarve që të marrin pjesë në seancën gjyqësore. Këto zyra, përveç atyre të kyetarëve të gjykatave që janë pak më të mëdha, janë me një hapsirë mjaft të ngushtuar. Vlen të theksohet se në rastet me shumë të pandehur është dashur që seancat gjyqësore të mbahen nëpër ambiente të tjera jashtë gjykatës, në mënyrë që të mundësohet pjesëmarrja e familjarëve, por edhe të bëhet akomodimi i përfaqësuesve të mediave dhe të të interesuarve të tjerë për të marrë pjesë në këto seanca.¹² Qasja e publikut në seancat gjyqësore rrit njohuritë e publikut me punën e gjykatave. Po ashtu kjo rrit edhe besimin e qytetarëve tek gjykatat. Në të ardhmen gjykatat e Kosovës duhet të kenë hapësira të mjaftueshme për zhvillimin e seancave gjyqësore në mënyrë transparente. Njohja e publikut me punën e gjykatave do të ishte edhe njëri ndër indikatorët të cilat në një masë të madhe do të ndikonin edhe në zvogëlimin e kriminalitetit dhe dukurive të tjera negative në shoqëri. Rritja e besimit të qytetarëve tek gjykatat, se me rastin e cënimit të ndonjë të drejte nga çdo lloj personi fizik apo institucion, ndikon edhe në zvogëlimin e veprimeve të vetëgjyqësisë dhe veprimeve të tjera në të cilat persona të ndryshëm tentojnë që të ngriten mbi ligjin. Rritja e besimit tek gjykatat do të parandalonte dhe dukuritë e ndryshme të vetëgjyqësisë dhe veprimeve të tjera arbitrare.

3. Qasja e Mediave në Procedurat Gjyqësore

Mediat në kohën bashkëkohore paraqesin një nga mjetet dhe format më efikase dhe më të shpeshta të transparencës. Ato konsiderohen si syri dhe veshi i opinionit.

⁹ Kodi i Procedurës Penale i Kosovës, neni 330.

¹⁰ Shih, Ligji për Familjen i Kosovës, neni 75.

¹¹ Po aty (neni 345).

¹² Me rastin e mbajtjes së shqyrtimeve gjyqësore në rastet e të ashtuquajturave Grupi i Dukagjinit dhe Grupi i Llapit, seancat janë organizuar në ambiente jashtë gjykatave.

Raportimet, historitë apo pjesët ineteresante nga proceset gjyqësore apo edhe të aktgjykimeve gjyqësore ishin, janë dhe mbetën çështje mjaft interesante për publikun. Shpeshhere kurajo e jonë për të kuptuar një ndodhi gjyqësore nga e kaluara, qoftë nga jeta politike, qoftë nga jeta private e ndonjë personaliteti mbeten edhe më tutje interesante për tu lexuar, komentuar apo edhe bënë pjesë e debateve tona.

Ndonëse rasti i vdekjes së princeshës angleze Diana kishte ndodhur para 13 viteve në Paris një lajm i publikuar në media lidhur me një vendim të Jurisë për shkaqet e vdekjes sikur nuk është vjetërsuar. Në njërin nga këto lajme thuhej:

Juria: ‘Princesha Diana vdiq nga neglizhenca’. Një hetim gjyqësor ka konkluduar se Princesha Diana dhe shoqëruesi i saj Dodi al Fayed janë vrarë nga një neglizhencë e madhe e shoferit të tyre dhe paparacëve. Juria e gjykatës gjithashtu ka specifikuar se shoferi ka ngarë makinën i dehur dhe faktin se as Diana dhe as al Fayed nuk e kanë pasur të vendosur rripin e sigurisë. Më shumë se 250 dëshmitarë janë marrë në pyetje gjatë 6 muajve të hetimit për aksidentin e vitit 1997 në Paris.¹³

Ky lajm ka gjetur vend në të gjitha mediat elektronike dhe të shkruara edhe në Kosovë. Lajmet nga gjyqi janë vërtetë interesante dhe tërheqëse për median: vrasjet e rënda, një divorc i të ashtuquajturve VIP-a etj, janë vërtetë interesante për t’u përfolur. Ato paraqesin edhe ngjarje reale nga jeta dhe njerëzit lënë bukën në gjysmë dhe me gojë të hapur do të ndjekin rrëfimin.¹⁴

Gjykata duhet të ruajë sekretin profesional, të ofrojë informacione për mediat, ndërsa media duhet që të transmetojë me profesionalizëm dhe korrektesë, pa hyrë në zonën që mund të jetë pengesë e punës së gjykatave. Në këtë lëmë ekzistojnë probleme me vlerë univesale, si dhe përgjegjësia e veçantë për të qenë e saktë, e plotë dhe të paanshëm - këtu s’ka vend për gabime.¹⁵

Në kushtet bashkëkohore aq rëndësi kanë mediat sa që tashmë “fuqia e letrës” ose më saktë media të quhet “pushteti i katërt” dhe kjo me siguri se prish skemën klasike të Monteskieut, sipas të cilës pushteti legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor janë të ndarë nga njëri tjetri.¹⁶

Qasja e mediave në procedurën gjyqësore në mënyrën më të qartë është e rregulluar me Kodin e Procedurës Penale, përkatësisht nenin 93(2)(3) sipas të cilit regjistrimet fotografike, filmike, televizive dhe regjistrime të tjera me anë të

¹³ <http://www.gazetastart.com/?faqe=shfaqflash&LajmID=20764,2008-04-30>.

¹⁴ F. Durmishi (n 1) 7-8.

¹⁵ Shih, Doracak gazetarësh, *Gazetaria moderne*, (Reporting for dhe Modern Media 2001) 57.

¹⁶ H. Boriçi, B. Gjergji, G. Tirana, S. Ramabaja, *Gazetaria* (Shtëpia Botuese e Librit Universitar 2000) 114.

pajisjeve teknike të seancës për konfirmimin e aktakuzës ose të shqyrtimit gjyqësor nuk lejohen në gjykatore. Kjo mund të bëhet me propozimin e palës ose të kryetarit të gjykatës dhe kur kjo gjë autorizohet nga ana e kryetarit të Gjykatës Supreme.

Vështirësi të dukshme në rastet e publikimit të rasteve gjyqësore në media ka paraqitur edhe jo profesionalizmi i duhur i gazetarëve dhe njohuritë e tyre të pakëta lidhur me ligjet në fuqi dhe procedurat gjyqësore. Gazetarët që raportojnë nga gjyqet domosdo duhet të kenë njohuri për termat ligjorë, për shkresat gjyqësore si dhe për procedurat në bazë të të cilave zhvillohen shqyrtimet gjyqësore. Ata gjithashtu duhet të dinë organizimin e gjykatave dhe hierarkinë e tyre. Këto në të shumtën e rasteve nuk kanë ndodhur me rastin e raportimeve nga seancat gjyqësore në Kosovë. Nga publikimet e shumta shpeshherë raportuesit nuk kanë mundur që të kuptojnë rolin e pjesmarrësve në procedurë dhe në raporte janë vërejtur thënie si prokurori i Gjykatës së Qarkut në Pejë, pastaj nuk ka qenë e mundur që të bëhet dallimi ndërmjet Aktvendimit dhe Aktgjykimit, apo nuk ka mundur të bëhet dallimi në mes të ndërprerjes së paraburgimit dhe liritë nga aktakuza. Reporterët gjithashtu shpeshherë nuk kanë qenë në gjendje që të bëjnë dallimin ndërmjet procedurave gjyqësore civile apo penale:

Në një rast në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë mediat për tri ditë më radhë vazhduan që të raportnin se të pandehurit janë liruar nga paraburgimi me vendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, ndërsa të pandehurit vazhdonin të qëndronin në paraburgim derisa paraburgimi atyre iu ndërpre pas 6 ditësh me vendimin e Gjykatës së Qarkut .

Mendojmë se që të gjitha këto gjëra kanë ndodhur edhe për faktin se sistemi gjyqësor në Kosovë vazhdon edhe më tutje që të jetë i mbyllur në vetevete. Pas, procedurave të ndjeshme dhe për rastet që kanë qenë kurioze për publikun, në mungesë të zëdhënësve për media apo edhe të deklarimeve të dikujt nga gjyqësori në opinion janë servitur gjithfarë informacionesh që nuk kanë përkuar me realitetin që është zhvilluar brenda në seancat gjyqësore. Jo rrallë herë, një gjë të tillë e kanë shfrytëzuar edhe mbrojtësit e palëve në procedurë (avokatët) të cilët duke shfrytëzuar këtë mungesë të transparencës së sistemit gjyqësor dhe mungesën e zëdhënësve kanë shfrytëzuar papërvojën e raportuesit medial por edhe neglizhencën e redaktorit konkret dhe përmes prononcimit medial publikut i kanë servitur versionin e vet lidhur me rastin, dhe i'a kanë bërë të besueshëm këtë gjë publikut sado që një gjë e tillë përfaqësuesve ligjor u është e ndaluar me Kodin e

Etikës.¹⁷ Kjo ka ndodhur në disa raste mjfat të ndjeshme dhe me interes për publikun në Kosovë.¹⁸

‘Në rastin e sipërcituar avokatët shfrytëzuan mediat për të bërë trysni ndaj gjyqësorit duke deklaruar se “Të pandehurit lirohen nesër”, apo “Gjykata Supreme topin e hodhi prap te Gjykata e Qarkut’.

Mediat kanë një rol të madh në krijimin e besimit te publikut në gjyqësor. Në zhvillimet e kohëve të fundit në Kosovë kur edhe shumë procese gjyqësore të cilat kanë peshën e vet në publikun e gjerë dhe priten me interes të madh, mediat kanë rolin e tyre të pa zëvendësueshëm në informimin e drejtë dhe në mënyrë të paanshme për publikun.

Qasja e mediave në procedurën gjyqësore dhe raportimi i tyre në mënyrë profesionale domosdo ndikon edhe në mbarëvajtjen e punës së gjykatave. Nëse një gjyqtar e di me siguri se aktgjykimi i tij ose një lëndë e tij do të analizohet në shtypin ditor ose do të komentohet nga kolegët e tjerë gjyqtarë nga gjykatat e tjera, profesionistët ligjorë apo profesorët e tij, është e sigurt se ai do të përqëndrohet me tërë kapacitetin e tij që të zhvillojë procedurën gjyqësore në mënyrë perfekte, të marrë një vendim të peshuar mirë dhe të argumentuar fuqishëm dhe do të ketë kujdes madje edhe se si do ta formulojë gjuhësisht.

Në të ardhmen në Kosovë gjykata dhe media duhet të ndihmojnë njëra-tjetrën. Pavarësia në informim është po aq e rëndësishme sa edhe pavarësia e gjyqësorit. Që të dy këto komponente duhet që të jenë të pavarura në Kosovë dhe i ndihmojnë edhe transparencës së gjykatave.

4. Konkluzione

Qasja e publikut në procedurën gjyqësore paraqet një ndër elementet kryesore të transparencës. Gjykata duhet të mbrojë sekretin profesional, të ofrojë informacione për mediat, ndërsa media duhet që të transmetojë me profesionalizëm dhe korrektesë, pa hyrë në zonën që mund të jetë pengesë e punës së gjykatave. Në këtë lëmë ekzistojnë probleme me vlerë univesale, si dhe përgjegjësia e veçantë për të qenë e saktë, e plotë dhe të paanshëm - këtu s’ka vend për gabime.

Në të ardhmen në Kosovë gjykata dhe media duhet të ndihmojnë njëra-tjetrën. Pavarësia në informim është po aq e rëndësishme sa edhe pavarësia e gjyqësorit. Që të dy këto komponente duhet që të jenë të pavarura në Kosovë dhe i ndihmojnë edhe transparencës së gjykatave.

¹⁷ Në takimin e mbajtur ndërmjet gjyqtarëve dhe avokatëve lidhur me problemet e ndërsjella në gjyqësorin e Kosovës, të mbajtur në Gjilan me 12 Maj 2006 është marrë qëndrim se “Avokati nuk duhet që të japë deklarata publike, gjatë kohës sa është duke punuar në një rast”

¹⁸ Në rastin ndërmjet A.S. dhe B.B të zhvilluar para Gjykatës Komunale në Prishtinë në mediat elektronike avokatët kanë dhenë versionet e tyre para mediave elektronike.

Gjatë raportimit të tyre mediat nganjëherë devijojnë nga misioni i tyre informativ. Duke bërë raportime një burimore ngelin ndërmjet transparencës dhe dhënies së informacionit të gabuar.